REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË FIER

Nr. 15622 Prot. Fier, më 18.11.2026

Lënda : Njoftim mbi zhvillimin e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak.

Drejtuar: ANËTARËVE TË KËSHILLIT BASHKIAK FIER

Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË FIER
PREFEKTIT TË QARKUT FIER

Në mbështetje të nenit 53 pika 4, nenit 56 pika 2, shkronja "a", te ligjit 139/2015 "Per vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar dhe Rregullores së Këshillit Bashkiak neni 61, ju njoftojmë thirrjen e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak Fier në sallën plenare të këshillit, ditën e **Enjte, datë 25.11.2026 në orën 12:00** me këtë rend dite:

1.Miratimi i Rendi të Ditës.

2.Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë **29.10.2026.**

3.Projekvendim nr.105 datë 18.11.2026 "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6 %, për muajin Tetor 2026."

4.Projektvendim nr.104 datë 17.11.2026 "Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë dhe miratimin e vlerës mesatare të qirasë në tregun e lirë, për efekt të llogaritjes së masës së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij, për vitin 2027".

5.Projektvendim nr.102 datë 17.11.2026 "Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programin social të strehimit "Subvencionimi i qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij" për vitin 2027.

6.Projektvendim nr.107 datë 18.11.2026 "Për miratimin e kërkesës së shoqërisë "Solen Energy" sh.p.k. me Nipt M31413007M për dhënien e të drejtës së kalimit "Për ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e linjës nëntokësore së transmetimit të energjisë elektrike" në pronat e Bashkisë Fier".

7.Projektvendim nr.108 datë 18.11.2026 "Për dhënien në përdorim të fondit pyjor në pronësi publike të Bashkisë Fier për shtrirjen e linjës elektrike 110 kw të centralit elektrik fotovoltaik 'Prosol Solar', me fuqi të instaluar 21 MW, për lidhjen me nënstacionin Hoxharë, me gjatësi 0.12445 km".

8.Projektvendim nr.99 datë 21.10.2026 "Për miratimin e transferimit të aseteve të lidhura me sistemin e furnizimit dhe trajtimit të ujit, pranë Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës-Kanalizimeve Fier, Sh.A.".

9.Projektvendim nr.106 datë 18.11.2026 "Për dhënien e mendimit/dakordësisë në parim mbi mënyrën e shfrytëzimit të hapësirës publike, pasurisë nr. 3/399 zk. 8534 (e llojit lulishte), me sipërfaqje totale 3 702 m2, lagja "Apolonia" Fier, në pronësi të Bashkisë Fier"

10.Projektvendim nr.103 datë 17.11.2026 "Për rimbursimin e shpenzimeve të transportit të nxënësve të arsimit parauniversitar, për vitin shkollor 2026-2027, me largësi mbi 2 km".

KRYETAR KËSHILLI

MELSI BOGDANI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA FIER